



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 7.06.2019

Dokument parlamentar

Komision përgjegjës)

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ORGANIZATËS PËR BASHKËPUNIM DHE
ZHVILLIM EKONOMIK (OECD), PËR BËRJEN PALË NË KUADRIN
GJITHËPËRFSHIRËS TË PROJEKTIT NDËRKOMBËTAR MBI EROZIONIN E
BAZËS SË TATUESHME DHE TRANSFERIMIN E FITIMIT (BEPS)”**

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 6.06.2019, mori në shqyrtim projektligjin projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), për bërjen palë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS)”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Z. Arben Ahmetaj.

Për të paraqitur projektligjin në emër të Qeverisë, ishin prezent Z. Niko Lera, përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 I saj dhe në përmbushje të nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi i projektligjit

Projektligji ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), për bërjen palë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar BEPS mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit.

Në maj të vitit 2016 dhe përsëri në mars 2018, Shqipëria mori ftesë nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) për t’iu bashkuar kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (ECD/G20 projekti BEPS), i cili u diktua si rezultat i krizës financiare dhe planifikimit agresiv tatimor.

Ky projekt ndërkombëtar dhe gjithëpërfshirës ka si synim arritjen e tre objektivave kryesorë:

1. Përforsim të koherencës së rregullave të tatimit mbi të ardhurat e korporatave në nivel ndërkombëtar;
2. Lidhjen e tatimit me përmbajtjen e aktiviteteve ekonomike të realizuara;
3. Përmirësim të transparencës.

Paketa gjithë përfshirëse BEPS (Inclusive Framework on BEPS), lejon dhe u jep mundësinë dhe vendeve që janë në zhvillim (jo vetëm atyre të zhvilluara) të punojnë në mënyrë të barabartë me anëtarët e OECD-së dhe G20 në zhvillimin e standardeve mbi çështjet që lidhen me BEPS-in si dhe rishikimin dhe monitorimin e implementimit të të gjithë paketës. Pra kështu përmes përfshirjes në këtë projekt, Shqipëria do të punojë së bashku në mënyrë të barabartë me 113 vende dhe juridiksione të tjera për të zbatuar paketën gjithë përfshirëse.

Përmbajtja e projektligjit

Projektligji përbëhet nga 3 nene gjithsej.

Neni 1, ratifikon marrëveshjen me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), për bërjen pjesë të Republikës së Shqipërisë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe shmangien e fitimit (BEPS).

Neni 2 përcakton kuotën e anëtarësisë vjetore në masën prej 20 200 eurosh vlerë e cila do të rishikohet në varësi të inflacionit vjetor.

Neni 3 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

Projektligji shoqërohet edhe nga plani i veprimit për erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimeve (BEPS), dokument ky që nuk është objekt i ratifikimit nga Kuvendi, pasi për Shqipërinë nuk është detyruese plotësimi i të gjitha masavë të tij por vetëm plotësimi i standardeve minimale.

IV. Efektet financiare

Ky projektligj parashikon shpenzime buxhetore pasi për bërjen palë të Republikës së Shqipërisë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS) do të paguhet një kuotë anëtarësie prej 20 200 (njëzet mijë e dyqind) eurosh në vit, vlerë e cila do të rregullohet dhe me inflacionin vjetor përkatës, të përcaktuar nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

V. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionin, relatori shpjegoi se së pari projektligji vjen pas miratimit në parim të tij, përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.628, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave.

Në vijim relatori evidentoi qëllimin e projektligjit si dhe theksoi se miratimi i tij, mundëson përgjigjen pozitivisht të Shqipërisë ndaj ftesës së Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), për t’iu bashkuar kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (ECD/G20 projekti BEPS), dhe njëkohësisht përmbush edhe një angazhim të Shqipërisë ndaj Komisionit Evropian, për bërjen pjesë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar BEPS në vitin 2019.

Pjesëmarrja në këtë projekt është plotësim i kriterit thelbësor që Shqipëria të mos jetë në listën e vendeve të kategorizuara si jo bashkëpunuese nga Komisioni Evropian në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar për çështjet e taksave. Gjithashtu kjo pjesëmarrje në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit i jep mundësinë vendeve anëtare, të punojnë në mënyrë të barabartë në trajtimin e shmangies tatimore, të përmirësojnë koherencën e rregullave të marrëveshjeve tatimore dhe të sigurojnë një ambient tatimor sa më transparent.

Në veçanti për të gjitha vendet pjesëmarrëse ky projekt ofron:

- zhvillimin e standardeve në lidhje me çështjet e BEPS-së;
- rishikimin dhe implementimin e standardeve minimale nëpërmjet një sistemi efektiv monitorimi;
- një forum për vendet që të nxjerrin në pah sfidat në zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe të gjejnë zgjidhje të reja, kjo është veçanërisht e rëndësishme për vendet në zhvillim;
- lehtësimin e procesit të implementimit duke ofruar orientim të mëtijshëm dhe suport për vendet në zhvillim, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve dhe drejtimin sipas platformës së bashkëpunimit për tatimet, e ngritur kjo nga organizatat ndërkombëtare (IMF, OECD, UN dhe ËB).

Në kuadër të këtij projekti ndërkombëtar, vendet anëtare marrin angazhimin për plotësimin e standardeve minimale të paketës BEPS, e cila në total përmbledh 15 plane veprimi. Kësisoj shtetet pjesëmarrëse pajisen me instrumente vendase dhe ndërkombëtare për të adresuar shmangien e taksave, në mënyrë që fitimet të tatohen aty ku kryhen aktivitetet ekonomike që i gjenerojnë ato dhe aty ku krijohet vlera.

VI. Përfundime

Në përfundim Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke evidentuar faktin se kjo marrëveshje është në përputhje me Kushtetutën si dhe legjislacionin në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare si dhe duke vlerësuar se marrëveshja do ti japë mundësinë Shqipërisë, të punojë në mënyrë të barabartë në trajtimin e shmangies tatimore, të përmirësojnë koherencën e rregullave të marrëveshjeve tatimore dhe të sigurojnë një ambient tatimor sa më transparent, me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

RELATOR

Arben AHMETAJ

KRYETAR

Arben AHMETAJ